

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6507
E martë, 11 janar 2022
çmimi 0.40 €

Kurti: Telekomit duhet të rikthehet si lider në treg | FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AMBASADORI I RI AMERIKAN NË KOSOVË, JEFFREY HOVENIER, FILLON PUNËN | FAQE 4-5

HOVENIER: SHËRBIMI NË KOSOVË ËSHTË NDER I JETËS



Ambasadori i ri amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, në gjuhën shqipe ka shprehur kënaqësinë e tij që do të shërbejë në Kosovë. Pas dorëzimit të letrave kredenciale në Presidencë, ai ka konfirmuar mbështetjen amerikane për shtetin e Kosovës. Diplomati amerikan ka bërë me dije se Kosova ka ende punë për të bërë, duke shtuar se ShBA-ja është partnere e qëndrueshme e Kosovës

AKTUALE



KADRI VESELI ARRIN NË KOSOVË | F. 5

ZKA-ja NIS AUDITIMIN E SISTEMIT TË LICENCIMIT TË HIDROCENTRALEVE | F. 7

SBASHK-U URON PUNËTORËT ARSIMORË PËR FILLIMIN E GJYSMËVJETORIT TË DYTË | F. 7

EKONOMI

AKB
Aleanca Kosovare e Bizneseve
Alliance of Kosovar Businesses

AKB-ja: BIZNESI ME KRIPTOVALUTA, DREJT DËSHITIMIT NË KOSOVË | F. 8


BANKAT NË KOSOVË FITUAN 107 MILIONË EURO PËR 11 MUAJ | F. 8

SPORT



DUSHKU: ZHVILLIMI DHE FUQIZIMI I KLUBEVE, PRIORITETE TË FBK-së | F. 10

Haradinaj del me dy propozime për ruajtjen e fshehtësive profesionale në polici | FAQE 3



IKSHPK-ja PARALAJMËRON PËRKEQËSIM TË SITUATËS EPIDEMIOLOGJIKE | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Suedia shtrëngon masat kundër pandemisë

STOKHOLM, 10 JANAR - Suedia ka njoftuar të hënën se ka vendosur masa të reja frenuese kundër koronavirusit, përfshirë shkurtimin e orarit të punës së bareve dhe restoranteve si dhe kufizimin e tubimeve publike. Ky shtet po përballet me rritje të madhe të rasteve për shkak të përhapjes së variantit Omicron të koronavirusit. Baret dhe restorantet do të mbyllën në orën 23:00 dhe dëshmia e vaksinimit do të kërkohej për të gjitha tubimet publike që mbahen në ambiente të mbyllura e ku marrin pjesë mbi 50 persona. Ndërkaq, tubimet private nuk mund ta kalojnë shifrën prej 20 personash. Këto masa do të hyjnë në fuqi të mërkurën, më 12 janar.

Me masat aktuale paraqitja e

dëshmisë së vaksinimit kërkohej vetëm në ngjarjet ku marrin pjesë më shumë se 500 persona. Me masat e reja, përveçse do të kërkohej që të ofrohet dëshmia e vaksinimit, qytetarët që do të marrin pjesë në ngjarje që do të zhvillohen në ambiente të mbyllura, duhet të kenë të paktën një metër distancë nga njëri-tjetri. “Tani ne jemi në një situatë ku kemi nivele rekord të transmetimit”, tha në një konferencë për medie kryeministria suedeze Magdalena Andersson.

Më 5 janar Suedia regjistroi 23 877 infektive ditore, që është shifra më e lartë e rasteve të reja që ky shtet ka regjistruar që prej fillimit të pandemisë. Në këtë shtet varianti Omicron është bërë dominues.

Me masat e reja qeveria ka



rekomanduar që qytetarët t'i kufizojnë ndërveprimet e tyre sociale dhe t'i shmangin ndejat

dhe darkat. Po ashtu, është rekomanduar puna nga shtëpia. Agjencia e Shëndetit Publik tha

se beson që masat e reja do të jenë në fuqi deri në mes të shkurtit, por ato do të shqyrtohen çdo dy javë.

Në fillim të pandemisë Suedia ishte një prej shteteve që nuk vendosi asnjë formë të izolimit dhe nuk mbylli shkollat. Ky shtet ndërmori një qasje më të butë duke rekomanduar distancimin shoqëror dhe punën nga shtëpia.

Që prej fillimit të pandemisë Suedia ka regjistruar rreth 15 300 viktima, shifër kjo që është pothuajse sa mesatarja e vdekjeve që kanë regjistruar edhe shtetet e tjera evropiane. Por, kjo shifër është më e lartë krahasuar me shtetet fqinje siç janë Norvegjia, Finlanda e Danimarka, që kishin kritikuar strategjinë e Suedisë në fillim të pandemisë.

Aung San Suu Kyi dënohet sërish me burgim



NAYPYIDAW, 10 JANAR - Një gjykatë në Mianmar, shtet i njohur edhe si Burma, ka dënuar të hënën lideren e rrëzuar nga pushteti, Aung San Suu Kyi, me katër vjet burgim. Ajo është dënuar për posedim ilegal dhe importim të radiolidhjeve si dhe shkelje të rregullave për luftim të pandemisë së koronavirusit. Suu Kyi është dënuar fillimisht në dhjetor të vitit të kaluar me dy vjet burgim. Ajo ka qenë nën arrest shtëpiak prej puçit ushtarak, që është kryer më 1 shkurt të vitit të

kaluar, dhe prej atëherë është përballur me akuza për të cilat është dënuar.

Disa i kanë komentuar dënimet ndaj saj si të paarsyetuara.

Besohet se akuzat e së hënës janë pasojë e ditës së puçit kur ajo është arrestuar, dhe i është bastisur shtëpia nga forcat e gjeneralit Min Aung Hlaing, të cilat kanë thënë se kanë gjetur pajisjet.

Seanca e së hënës në gjykatë është zhvilluar me dyer të mbyllura dhe avokatëve të lideres

së rrëzuar u është ndaluar që të komunikojnë me mediet dhe publikun.

Vendimi i fundit nënkupton se ajo do të qëndrojë në burg për gjashtë vjet.

Muajin e kaluar Suu Kyi, laureate e Çmimit Nobel, është shpallur fajtorë për nxitje të disidentëve dhe shkelje të rregullave për koronavirus.

Ky vendim është konsideruar i “turpshëm” nga shefja e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat të Njeriut, Michelle Bachelet.


Të paktën 19 të vdekur pas shpërthimit të zjarrit në një ndërtesë në Nju-Jork

NJU-JORK, 10 JANAR - Të paktën 19 persona, përfshirë nëntë fëmijë, janë vrarë pas shpërthimit të një zjarri në një banesë në qytetin e Nju-Jorkut. Autoritetet lokale thanë se ky ishte zjarri më vdekjeprurës në vitet e fundit. Stefan Ringel, këshilltar i kryetarit të Nju-Jorkut, Eric Adams, konfirmoi për “Associated Press” numrin e viktimave, teksa një zyrtar tjetër lokal konfirmoi numrin e fëmijëve të vrarë nga zjarri. Dhjetëra persona të tjerë u lënduan, ndërkaq 13 persona janë në gjendje kritike, tha Ringle. Rreth 200 zjarrfikës u angazhuan teksa zjarri shpërtheu në një ndërtesë 19-katëshe në Bronks. Zjarrfikësit “gjetën viktima në çdo kat dhe viktimat kishin pësuar arrest kardiak apo

respirator”, tha zyrtari i shërbimit të zjarrfikësve, Daniel Nigro.

“Kjo është e paprecedent në qytetin tonë. Ne presim që të ketë më shumë viktima”, shtoi ai. Ai e krahasoi këtë ngjarje me zjarrin që kishte shpërthyer në një klub shoqëror më 1990 ku ishin vrarë 87 persona. Sipas Nigro, zjarri të dielën shpërtheu në një banesë që gjendej në katin e dytë dhe të tretë. Zjarrfikësit kishin gjetur hapur derën e kësaj banese që, sipas tyre, mundësoi që zjarri të përhapej me shpejtësi në katet e tjera të ndërtesës.

Autoritetet janë duke hetuar shkaqet e zjarrit. Shpërthimi i zjarrit në Nju-Jork vjen disa ditë pasi një shtëpi në Filadelfi u dogj duke vrarë 12 persona, përfshirë tetë fëmijë.



IKShPK-ja paralajmëron përkeqësim të situatës epidemiologjike

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 JANAR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) ka njoftuar se situata epidemiologjike në Kosovë mund të përkeqësohet si pasojë e përhapjes së variantit Omicron të koronavirusit. "IKShPK-ja është duke vazhduar pandërprerë testimin dhe gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik.

Situata epidemiologjike mund të përkeqësohet edhe më shumë ditët në vazhdim, andaj IKShPK-ja apelon te të gjithë qytetarët që të respektohen masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës", ka njoftuar ky institut.

Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të përhapjes së Covid-19,

IKShPK-ja ka bërë thirrje për kujdes dhe mosgrumbullim. "U rekomandojmë institucioneve përgjegjëse ta mbikëqyrin me përpikëri gjendjen dhe t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave për parandalimin dhe luftimin e pandemisë. Është i domosdoshëm kujdesi i shtuar i të gjithëve që në mënyrë strikte të respektohet distanca fizike, të përdoren maskat, të bëhet dezinfektimi dhe ajrosja e hapësirave, duke pamundësuar dhe shmangur përhapjen eventuale të mëtejme të infeksionit Covid-19", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se mënyra më e mirë për mbrojtje nga Covid-19 është vaksinimi.

"Duke qenë se vaksinimi është mënyra më e mirë dhe më e sigurt për ta parandaluar Covid-19, veçanërisht format e rënda të



sëmundjes dhe vdekjet, ne vazhdojmë të apelojmë fuqishëm për vaksinim sa më gjithëpërfshirës, sa më të gjerë

dhe sa më të shpejtë të popullatës nga mosha 12-vjeçare", theksohet në njoftimin e IKShPK-së.

Ky institut ka njoftuar se vaksinat

mund të merren çdo ditë në të gjitha institucionet e kujdesit parësor në komuna.

IKShPK-ja ka apeluar për vaksinimin me dozën përforcuese dhe dozën e tretë që mund ta marrin të gjithë qytetarët e moshës mbi 18-vjeçare. "Duke u vaksinuar vetë, ju mbron veten, mbron edhe njerëzit përreth jush, në rend të parë familjen. Vaksinimi mbetet arma më e fortë për ta parandaluar hospitalizimin. Të gjithë pa dallim dhe domosdoshmërisht duhet të vazhdojmë t'i zbatojmë masat parandaluese kundër Covid-19 dhe rekomandimet e profesionistëve shëndetësorë", është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

Në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës në trajtim mjekësor janë 16 pacientë të konfirmuar me Covid-19 pozitivë dhe 24 të tjerë post-Covid.

Me oksigjeno-terapi janë 11 pacientë, kurse në Mjekimin Intensiv të Klinikës Infektive nuk ka asnjë pacient.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të hënën se nga 8 460 testime, 236 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të hënën janë shëruar 8 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 158 142. Në total numri i rasteve aktive është 1 780. Në 24 orët e fundit janë dhënë 904 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 693 666 doza të vaksinës. Deri më sot 790 175 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.



Ministri Latifi viziton IKShPK-në

Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, i shoqëruar nga zëvendësministri Dafina Gexha-Bunjaku dhe zëvendësministri Arsim Berisha qëndruan të hënën në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës. Ata u njoftuan nga drejtori i IKShPK-së, profesor Naser Ramadani, lidhur me punën e IKShPK-së gjatë pandemisë Covid-19, aktivitetet e departamenteve aty dhe aktivitetet në vijim për mbikëqyrje të situatës epidemiologjike në vend.

Ministri Latifi ka shprehur falënderimin e tij për punën që ka bërë IKShPK-ja gjatë pandemisë,

duke vlerësuar se gjatë kësaj periudhe të vështirë, Kosova, me gjithë kapacitetet e kufizuara në shëndetësi, ia ka dalë të tregojë përkushtim në mbajtjen nën kontroll të situatës epidemiologjike dhe menaxhimin e saj. Në takim u theksua si shumë i rëndësishëm vaksinimi i popullatës si ndaj Covid-19 ashtu edhe ndaj gripit sezonal, zbatimi i masave në fuqi dhe mbikëqyrja e plotë e situatës epidemiologjike me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik, në këtë kohë të qarkullimit të varianteve të ndryshëm të SARS COV-2, përfshirë edhe variantin shqetësues Omicron.

Ministri Latifi ka theksuar se nga zbatimi i masave në fuqi varen edhe vendimet në të ardhmen, prandaj ai theksoi se shëndeti i qytetarëve është prioriteti i parë për MSh-në, pa lënë anash edhe funksionimin e veprimtarive të tjera të rëndësishme ekonomike, sociale, kulturore... të cilat janë të ndërlidhura me zbatimin e masave kundër Covid-19.

Ministri gjatë vizitës në IKShPK ka qëndruar edhe në laboratorët e Institutit si dhe ka diskutuar me drejtuesit e IKShPK-së edhe për aktivitete të tjera të rëndësishme që ky institut kryen, përveç fokusit në Covid-19.

Vazhdon zbatimi i urdhrorit operativ për kontrollimin e transportit publik

PRISHTINË, 10 JANAR - Policia rajonale në Prizren ka njoftuar se patrullat e stacionit policor në Prizren, Prizren-Veri, Dragash,

Suharekë dhe Mamushë, sipas urdhrorit operativ, kanë vazhduar masat e ndërmarra për mjetet e transportit publik si dhe kontrollimin e masave

kundër Covidit. Gjatë pikave të kontrollit dhe lokaleve të kontrolluara janë shqiptuar 380 gjoja për kundërvajtje të trafikut,

ndërsa për masat kundër Covidit janë shqiptuar 200 gjoja. Policia ka njoftuar se aktivitetet e tilla do të vazhdojnë edhe më tutje.





AMBASADORI I RI AMERIKAN NË KOSOVË, JEFFREY HOVENIER, FILLON PUNËN

Hovenier: Shërbimi në Kosovë është nder i jetës

Ambasadori i ri amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, në gjuhën shqipe ka shprehur kënaqësinë e tij që do të shërbejë në Kosovë. Pas dorëzimit të letrave kredenciale në Presidencë, ai ka konfirmuar mbështetjen amerikane për shtetin e Kosovës. Diplomati amerikan ka bërë me dije se Kosova ka ende punë për të bërë, duke shtuar se ShBA-ja është partnere e qëndrueshme e Kosovës

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 10 JANAR - Ambasadori i ri amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, zyrtarisht ka marrë detyrën të hënën. Në ditën e parë të punës së tij ai ka thënë se është nder i jetës së tij të jetë ambasador i ShBA-së në

Kosovë. Pas dorëzimit të letrave kredenciale te presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në gjuhën shqipe ai është shprehur i gëzuar që do të shërbejë në Kosovë, duke konfirmuar mbështetjen e ShBA-së për shtetin e Kosovës. “Unë jam shumë i gëzuar me qenë këtu në Kosovë. Kjo është e vetmja fjali

që unë e di në gjuhën shqipe”, ka thënë Hovenier.

Diplomati amerikan ka deklaruar se në Kosovë ende ka punë të papërfunduara. “Presidenti Biden ma besoi detyrën në një kohë kur këtu ka ende punë të papërfunduara. Do të punojmë me ju, me qeverinë, me shoqëritë civile, me qytetarët tuaj. Zotimet e presidentes për zhvillimin e institucioneve të pavarura, sistemit gjyqësor, janë shumë të rëndësishme që të ecim përpara drejt institucioneve euroatlantike. Është fillim i një dialogu dhe është një hap i mrekullueshëm”, ka thënë Hovenier në një konferencë të përbashkët për medie me

presidenten Osmani. Sipas tij, Kosova ka arritur që të vendoset në skenën globale si një shtet i suksesshëm demokratik dhe shumetnik.

Ambasadori Hovenier ka deklaruar se do ta përcjellë përkushtimin e ShBA-së për Republikën e Kosovës. “Duhet falënderuar njerëzit e Kosovës që kanë punuar për të ndërtuar një shtet të suksesshëm. Është nder për karrierën time që kam punuar në procese që kanë pasur të bëjnë për Kosovën dhe nder për jetën time që do të punoj këtu. Ka ende shumë punë për të bërë si në çdo shtet. ShBA-ja është partnere e qëndrueshme e Kosovës”, ka deklaruar Hovenier. Ai ka

theksuar se ShBA-ja do ta mbështesë Kosovën që ta luajë rolin e saj të drejtë në rajon, në kontekstin paqësor dhe për të mirën e të gjithëve.

Kurse presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka deklaruar se Kosova dhe Shtetet e Bashkuara përfaqësojnë vlera të përbashkëta demokratike. “Vendi ynë, Kosova, i beson dhe i përfaqëson vlerat që i përfaqësojnë Shtetet e Bashkuara. Dy popujt tanë besojnë në liritë demokratike dhe ne jemi të vendosur t'i mbrojmë ato gjithmonë, meqë i kemi fituar me shumë mund dhe sakrificë”, është shprehur Osmani.

Ajo ka thënë se këto dy vende do


Tërmet i fuqishëm në Greqi, dridhjet ndihen edhe në Kosovë

PRISHTINË, 10 JANAR - Një tërmet prej 5.5-shkallësh të Rihterit goditi Greqinë mbrëmjen e 9 janarit në orën 21:43. Ky tërmet i fuqishëm u ndie edhe

në shtetet fqinje, përfshirë edhe Kosovën. Sipas Qendrës Sizmologjike Evropiane-Mesdhetare, epiqendra e tërmetit ishte katër kilometra

në verilindje të Florinës në Greqi dhe 119 kilometra në lindje të Elbasanit në Shqipëri. Tërmeti u ndie edhe në Shqipëri dhe Maqedoni të

Veriut. Thellësia e tërmetit ishte 10 kilometra. Ende nuk ka raportime për dëme nga tërmeti.



t'i forcojnë raportet e tyre. "Ne jemi rritur e zhvilluar si vend sepse jemi të bekuar ta kemi ShBA-në pranë nesh. Roli i ambasadorit është thelbësor që marrëdhënia jonë të vazhdojë të lulëzojë. Në këtë kapitull të ri shpresoj t'i forcojmë marrëdhëniet tona dypalëshe, t'i shtyjmë idealet dhe vlerat demokratike që ne besojmë", është shprehur Osmani. Sipas saj, Kosova është e bekuar që ka një aleat si Shtetet Bashkuara të Amerikës. "Kosova sot është shumë ndryshe nga Kosova të cilën e kujton ambasadori sepse ka ecur përpara, por një gjë është e njëjtë, marrëdhënia me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Jemi të bekuar të kemi ShBA-në pranë nesh në çdo hap të rrugëtimit tonë. Në këtë kapitull të ri bashkëpunimit shpresoj të forcojmë edhe me tej marrëdhëniet tona. Besoj fuqishëm se pavarësisht sa i madh apo i vogël mund të jetë

Hovenier bën homazhe te shtatorja e Ibrahim Rugovës

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeff Hovenier, në ditën e parë të punës ka zgjedhur të bëjë homazhe te shtatorja e ish-presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova. Bashkë me Osmanin, Hovenier ka vendosur kurora me lule te shtatorja e Rugovës. "Kam nderin të jem këtu për ta njohur kontributin dhe historinë e presidentit Rugova. Desha ta bëj këtë në ditën time të parë si ambasador i ShBA-së në Kosovë. Për shkak të respektit për presidentin Rugova, atë çfarë ai ka përfaqësuar. Pata nderin ta njoh atë në procesin e Rambujesë", ka thënë ambasadori i ShBA-së.

një shtet, ne të gjithë mund të japim kontribut për paqen në rajon dhe botë", ka thënë Osmani.

Ambasadori Hovenier pason ish-ambasadorin Philip Kosnett në pozitën e ambasadorit në Kosovë. Hovenier është

Von Cramon mirëpret ardhjen e ambasadorit të ri amerikan

Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian (PE), Viola von Cramon, i ka uruar mirëseardhje në Prishtinë ambasadorit të ri të ShBA-së, Jeff Hovenier. Viola von Cramon ka shkruar në llogarinë e vet në "Twitter" se mezi pret të takohet me ambasadorin e ri amerikan, i cili të hënën ia ka dorëzuar letrat kredencialet presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani. "Mirë se erdhët në Prishtinë ambasador Hovenier! Mezi pres të takohem me ju dhe ekipin tuaj dhe ta përforcojmë bashkëpunimin e mëtijshëm BE - ShBA", ka shkruar ajo.

diplomat karriere i shërbimit të jashtëm amerikan, i cili ka qenë pjesë e stafit të të dërguarit të posaçëm të Kombeve të

Bashkuara për statusin e Kosovës. Mandati i ambasadorit të ShBA-së në Prishtinë është tri vjet.



Kadri Veseli arrin në Kosovë

PRISHTINË, 10 JANAR - Ish-kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka ardhur të hënën në shtëpinë e tij në Mitrovicë, pas vdekjes së nënës së tij Ajshe, e cila ndërroi jetë të premten në moshën 93-vjeçare.

Të hënën para shtëpisë janë parë bashkëshortja e Veselit, Violeta Veseli dhe fëmijët. Kadri Veseli është kapur nga kamerat duke zbritur nga vetura. Veseli edhe muaj më parë kishte ardhur në Kosovë për arsye familjare, pasi humbi

edhe babanë pak kohë më parë. Veseli së bashku me ish-presidentin Hashim Thaçi, ish-kryetarin e Kuvendit, Jakup Krasniqi dhe ish-deputetin Rexhep Selimi po mbahen në paraburgim në Hagë nga Gjykata Speciale.



Ministria e Infrastrukturës thotë se të gjitha rrugët janë të kalueshme

PRISHTINË, 10 JANAR - Ministria e Infrastrukturës ka bërë me dije se të gjitha rrugët janë të kalueshme. Në njoftimin për medie kjo ministri thekson se ekipet për mirëmbajtjen e rrugëve po vazhdojnë ta kryejnë detyrën e tyre. "Sipas informatave të cilat janë marrë nga terreni nga menaxherët e

mirëmbajtjes, të gjitha rrugët nacionale dhe regjionale si dhe autoudhët janë të qarkullueshme për të gjitha llojet e automjeteve. Edhe pse ka pasur reshje të vazhdueshme të borës në 24 orët e fundit, kompanitë e mirëmbajtjes kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë në aktivitet

të vazhdueshëm, të pastrimit të rrugëve. Kujdes të veçantë po u kushtohet rrugëve që shtrihen në lartësi të mëdha mbidetare sepse aty paraqiten ngrica herë pas here. Kërkojmë nga ana e vozitësve që t'i respektojnë rregullat e vozitjes gjatë kësaj kohe!", ka njoftuar Ministria e Infrastrukturës.



ZKA-ja nis auditimin e sistemit të licencimit të hidrocentraleve

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 JANAR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka filluar auditimin e performancës në fushën e energjisë dhe mjedisit me temën "Sistemi i licencimit të hidrocentraleve dhe ndikimi i tyre në mjedis dhe ujëra (2015-2021)".

Trajtimi i kësaj teme të auditimit është me rëndësi të veçantë pasi që shfrytëzimi i ujërave për prodhimin e energjisë elektrike duhet të bëhet në mënyrë të duhur duke mos ndikuar në cilësinë dhe rrjedhën e ujërave. "Raportimet e ndryshme në medie dhe hulumtimet fillestare në fazën e planifikimit në këtë fushë tregojnë se ka indikacione që procesi i licencimit të hidrocentraleve karakterizohet me mangësi dhe mungesë të transparencës. Po ashtu, ka indikacione për moskoordinim në mes të palëve përgjegjëse gjatë procesit të licencimit, mungesë të mbikëqyrjes së duhur nga institucionet përgjegjëse që për pasojë mjedisi mund të rrezikohet nga kjo veprimtari. Ndikimi që ka kjo veprimtari në mjedis dhe treguesit fillestarë të problemeve në këtë fushë kanë shërbyer që ZKA-ja të fillojë këtë auditim", është theksuar në njoftimin për media të ZKA-së.

Zyra Kombëtare ka bërë me dije se objektivë e këtij auditimi është vlerësimi i dhënies së licencave për hidrocentralet dhe aktivitetet e institucioneve publike për mbrojtjen e mjedisit nga veprimtaria e hidrocentraleve. "Qëllimi kryesor i këtij auditimi është që



të kontribuojë për përmirësimin e procesit të licencimit dhe të sigurojë se shfrytëzimi i ujërave bëhet në mënyrë më efikase dhe efektive duke arritur qëllimin e synuar dhe të sigurohet mbrojtja e ujërave dhe mjedisit", është thënë në njoftimin për media të ZKA-së, duke theksuar se procesit të auditimit do t'i nënshtrohen Zyra e Rregullatorit të Energjisë; Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Ministria e Ekonomisë si dhe komuna e Dragashit, Mitrovicës, Deçanit dhe komuna e Shtërpçës. Po ashtu, auditimit mund t'i nënshtrohen edhe Agjencia e Pyjeve të Kosovës dhe Ministria

e Kulturës Rinisë dhe Sportit varësisht nëse kanë ndërlidhje me fushën e audituar. ZKA-ja ka theksuar se në kuadër të këtyre institucioneve fokus i auditimit do të jenë departamentet e lëshimit të lejeve dhe departamentet e inspektoratit lidhur me ndikimin në mjedis dhe ujëra. Sipas këtij njoftimi, fushëveprimi do të fokusohet te dhënia e licencave për hidrocentralet përgjatë viteve 2015-2020 dhe ndikimi i tyre në mjedis dhe ujëra. "Qëllimi kryesor i ndërtimit të hidrocentraleve në Kosovë është arritja e caktuar prej 25-përqindësh krahas marrëveshjes së Direktivës së vendosur të BE-së 2019/32/EC

për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme deri në vitin 2020 duke zvogëluar ndikimin në mjedis dhe ujëra. Në Kosovë përgjatë viteve 2015-2020 janë ndërtuar rreth 20 hidrocentrale të vogla të cilat ofrojnë një kapacitet të prodhimit rreth 86 MW. Hidrocentralet duhet të ndërtohen në koncesion me institucionet publike, të pajisen dhe t'i zbatojnë rregullat dhe kriteret e lejeve mjedisore me qëllim të mbrojtjes së ujërave dhe mjedisit dhe ta sigurojnë cilësinë e prurjes së ujërave dhe rrjedhën e tyre", ka njoftuar ndër të tjera ZKA-ja. Sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit, aktivitetet e secilit institucion përgjegjës për

ndërtimin e hidrocentraleve dhe funksionalizimin e tyre me qëllim të prodhimit të energjisë elektrike duhet të zhvillohen në pajtim me parimet e pajtueshmërisë, ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit. Po ashtu, të ofrojnë transparencë dhe trajtim të barabartë për operatorët ekonomikë të cilët synojnë shfrytëzimin e ujërave për prodhim të energjisë. ZKA-ja është e përkushtuar të kryejë tema relevante dhe të rëndësishme për Kuvendin e Kosovës dhe qytetarët duke ofruar rekomandime të dobishme për mbrojtjen e mjedisit dhe fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë", është thënë në njoftimin e ZKA-së.

Dhjetë shtëpi për familjet në nevojë

Podujevë, 10 janar - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka nënshkruar të hënën marrëveshje bashkëpunimi me humanistin Halil Kastrati për ndërtimin e dhjetë shtëpive të reja për familjet në nevojë.

Komuna e Podujevës do të participojë me nga 5 000 euro për secilën shtëpi, ndërsa pjesën tjetër do ta mbulojë shoqata "Jetimat e Ballkanit". Kryetari Bulliqi ka falënderuar hoxhën e nderuar për ndihmën e vazhdueshme në komunën e Podujevës,

gjithashtu ka falënderuar edhe të gjithë donatorët të cilët po mundësojnë realizimin e këtij projekti. "Bashkë do të vazhdojmë të punojmë dhe të realizojmë projekte që do ta përmirësojnë jetën e qytetarëve tanë", ka thënë Bulliqi.



SBASHK-u uron punëtorët arsimorë për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 10 JANAR - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës e Kosovës (SBASHK) i ka uruar punëtorët arsimorë për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë. "Të nderuar punëtorë të arsimit, me respektin më të lartë ju përgëzojmë për gatishmërinë dhe angazhimin që gjysmëvjetori i dytë të nisë me sukses. Urojmë që të kemi sa më pak telashe e vështirësi me pandeminë dhe ta vazhdojmë betejën për dije të reja edhe përkundër mungesës së kushteve për punë dhe të mjeteve bashkëkohore të mësimi. Gatishmëria dhe vullneti juaj në misionin e shenjtë të edukimit e arsimit të brezave na bën të ndihemi krenarë dhe ju premtojmë se ne do të vazhdojmë ta ruajmë besimin tuaj duke u angazhuar tani e gjithmonë që të jemi zë i juaj dhe t'i realizojmë kërkesat tuaja legjitime", thënë në komunikatën e SBASHK-ut.

SBASHK-u ka bërë thirrje për angazhim maksimal për respektimin e rekomandimeve të IKShPK-së duke ruajtur kështu shëndetin e nxënësve. "Ju përgëzojmë edhe për gatishmërinë e shprehur vazhdimisht që të angazhoheni e të veproni sipas vendimeve të institucioneve përgjegjëse lidhur me situatat që mund të krijohen, sepse fatkeqësisht numri i të



Ministrja Nagavci viziton shkollën "Faik Konica"

Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, me rastin e fillimit të periudhës së dytë të vitit shkollor 2021/22, ka vizituar shkollën "Faik Konica" në Prishtinë prej ku ka përcjellë mesazhin për fillimin e periudhës së dytë të vitit shkollor me urimin që edhe kjo periudhë të shkojë mirë dhe nxënësit të kenë kuriozitet për të mësuar gjëra të reja. Ministrja Nagavci i ka ftuar

nxënësit dhe mësuesit, si dhe stafin tjetër të shkollave, që të kenë kujdes maksimal për respektimin e masave mbrojtëse në mënyrë që procesi mësimor të vazhdojë të zhvillohet me prani fizike.

Gjatë bashkëbisedimit që pati me mësuesit e kësaj shkolle, ministrja Nagavci tha se të gjitha rekomandimet e institucioneve shëndetësore janë që shkollat të mbahen të hapura, për çka edhe kërkoj

vaksinim të plotë dhe angazhim të përbashkët në mënyrë që të përmbillet me sukses edhe kjo periudhë.

Duke folur për gjendjen e përgjithshme në arsim, ministrja Nagavci tha se ka pritshmëri që Kosova të shënojë sukses më të mirë në testin PISA, i cili do të organizohet gjatë këtij viti, ndërkaq shtoi se përmirësimi i gjendjes është i mundur vetëm me angazhimin e të gjithëve.

Haradinaj del me dy propozime për ruajtjen e fshehtësisë profesionale në polici

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 JANAR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka kërkuar nga institucionet e Kosovës t'i heqin pajisjet për vëzhgim dhe interceptim të vendosura nga Serbia. Përmes një postimi në llogarinë e tij në "Facebook", Haradinaj ka thënë se është

shumë e rëndësishme ruajtja e fshehtësisë profesionale nga institucionet e rendit dhe të sigurisë. "Ruajtja e fshehtësisë profesionale nga institucionet e rendit dhe sigurisë është shumë e rëndësishme dhe e ndjeshme", ka shkruar Haradinaj.

Haradinaj ka kërkuar veprim me urgjencë nga ana e institucioneve të sigurisë në dry drejtime. "Për këtë arsye, institucionet e sigurisë, veçanërisht Policia e

Kosovës duhet ta rrisë kontrollin e brendshëm dhe të veprojë me urgjencë në dy drejtime: 1. Eliminimi i të gjitha pajisjeve për vëzhgim dhe interceptim, të vendosura në territorin e Kosovës nga Serbia dhe aleatët e saj; 2. Investimi në pajisje të avancuara në partneritet me aleatët tanë të sigurisë për komunikim të sigurt dhe të mbrojtur nga interceptimi i Serbisë dhe i aleatëve të saj", ka thënë Haradinaj.

Kujtim Gashi emërohet nënkryetar i komunës së Prizrenit

Prizren, 10 janar - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka filluar emërimet në pozita politike në kabinetin e tij. Kujtim Gashi është emëruar nënkryetar i komunës së Prizrenit.

Kujtim Gashi është nënkryetar i Degës së PDK-së në Prizren, anëtar i Kryesisë Qendrore dhe ka qenë shef i Shtabit Zgjedhor

në zgjedhjet e fundit lokale. Gashi ka mbajtur pozita të rëndësishme në nivel qendror dhe lokal, ka përvojë politike mbi 20-vjeçare. Po ashtu, Gashi është njohës shumë i mirë i politikave lokale, ka qenë asamblist për tre mandate, kryesues për një mandat dhe ka gjashtë vjet përvojë pune në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Ai ka qenë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Përvoja e tij shumëvjeçare në politikë, profesionalizmi i tij dhe njohja e politikave lokale e bëjnë Kujtim Gashin të denjë për këtë pozitë dhe ai do të jetë vlerë e shtuar në kabinetin e kryetarit të komunës së Prizrenit.



Kurti: Telekomu duhet të rikthehet si lider në treg

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 10 JANAR - Qeveria e Kosovës synon që gjatë këtij viti Telekomu i Kosovës të jetë lider në tregun e telekomunikacionit në mënyrë që të rikthehet në kompani përfituese, kontribuuese dhe jo shpenzuese të buxhetit të Kosovës. Kështu ka thënë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë një vizite që i bëri të hënën kësaj kompanie.

Telekomu i Kosovës dikur ka qenë kompania më fitimprurëse në vend, kurse vitet e fundit është duke u përballur me një situatë të rëndë financiare. Kjo situatë, sipas ekspertëve të telekomunikacionit, ka ardhur si pasojë e kontratave të dëmshme, vendimmarrjes së gabuar, mungesës së investimeve, ndërhyrjes së politikës në vendimmarrje strategjike të kompanisë dhe nepotizmit.

Për ta ndihmuar këtë kompani, Qeveria e Kosovës vitin e kaluar ka ndarë si dividendë 10 milionë euro. "Ne jemi të interesuar që Telekomu i Kosovës - Vala - ta bëjmë lider në Kosovë ashtu siç

ka qenë më herët. Për këtë arsye i kemi dhënë mbështetje financiare vitin që lamë pas. Në vitin 2022 jemi të interesuar ta nxjerrim përfundimisht Telekomu nga kriza", ka deklaruar Kurti.

Nga viti 2008 deri në vitin 2015 Telekomu i ka paguar Qeverisë së Kosovës mbi 250 milionë euro dividendë. Këto mjete Qeveria e Kosovës i ka marrë nga Telekomu deri në vitin 2015, kur edhe ka filluar kriza financiare në Telekom.

Dividendi është fitim i kompanisë që duhet t'i dorëzohet pronarit, në këtë rast qeverisë.

Ministrja e Ekonomisë në Kosovë, Artane Rizvanolli, ka thënë se në tetë muajt e fundit ka pasur përmirësim në këtë ndërmarrje. "Bordi dhe menaxhmenti i Telekomit kanë qenë aktivë dhe të suksesshëm për rritjen e performancës, uljen e shpenzimeve operative, ndërprerjen e kontratave të dëmshme, parandalimit dhe shfuqizimit të gradimeve të paligjshme. Kanë bërë gjashtë kallëzime penale për kontrata të ndryshme që janë gjetur në të kaluarën dhe kanë nisur një proces të ristrukturimit për të



cilën e kanë përkrahjen tonë", ka thënë Rizvanolli.

Telekomu i Kosovës është kompani publike, e transformuar në shoqëri aksionare, në të cilën

operon telefonia fikse dhe ajo mobile, Vala. Operatori Vala ka mbi 1.2 milion konsumatorë në nivel vendi. Në këtë kompani janë të punësuar rreth 2 500

punonjës. Telekomu i Kosovës i është nënshtruar dy herë procesit të privatizimit, mirëpo asnjëri prej tyre nuk është finalizuar me sukses.

Bankat në Kosovë fituan 107 milionë euro për 11 muaj



PRISHTINË, 10 JANAR - Më shumë se 107 milionë euro është profiti i pastër neto i bankave komerciale që operojnë në vendin tonë vetëm gjatë periudhës janar-nëntor 2021. Në raportin e fundit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) thuhet se gjatë periudhës janar-nëntor 2021 të hyrat e bankave ishin 292,5 milionë euro, shpenzimet totale 184,9, derisa fitimi i pastër net 107.5 milionë euro derisa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak ishte dukshëm më i ulët 70,8 milionë euro.

Gjatë kësaj periudhë kohore me fitim rekord përformuan edhe institucionet

mikrofinanciare. Sipas BQK-së, fitimi i pastër i tyre vetëm për 11 muaj ishte 12.9 milionë euro, derisa vitin paraprak e kishin mbyllur me 1,1 milion euro humbje.

Edhe kompanitë e sigurimeve që operojnë në vendin tonë gjatë periudhës janar-nëntor 2021 e kanë përmbyllur me 5,9 milionë euro fitim derisa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak kishin regjistruar një profit prej 4,9 milionë eurosh. Përndryshe, bankat komerciale në Kosovë kanë 3506 të punësuar, ku nga gjithsej 11 banka komerciale që operojnë në vend, 9 prej tyre janë me kapital të huaj dhe dy me kapital vendor.

AKB-ja: Biznesi me kriptovaluta, drejt dështimit në Kosovë

PRISHTINË, 10 JANAR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) përmes një reagimi për medie ka theksuar se biznesi me kriptovaluta po dështon në Kosovë në mungesë të ligjeve për të legalizuar dhe mbrojtur këtë sektor financiar virtual, i cili shumë qytetarëve dhe bizneseve u ka sjellë përfitime të larta.

"Qeveria e Kosovës mori vendim për t'i sekuestruar pajisjet për prodhimin e kriptovalutës kinse për të kursyer energji elektrike. Sipas një hulumtimi të AKB-së, qytetarët tanë kanë investuar në forma të ndryshme në këtë sektor mbi 10 milionë euro, por përfitimet nga këto investime

kapin vlerën mbi 50 milionë euro gjë që përfituesit nuk kanë treguar gatishmëri për të paguar tatim në fitim. Qeveria e Kosovës duhet të përpilojë ligje me të qarta për këto investime tash me trend global dhe t'ua mundësojë qytetarëve këtë biznes legal", është bërë me dije në reagimin e AKB-së.



Tre gjërat që mësova kur avioni im u rrëzua

Një prej prezantimeve më mbresëlënëse në TED Talks, nga Ric Elias



Imagjinoni një shpërthim të madh, teksa jeni duke fluturuar në një lartësi mbi një mijë metra. Imagjinoni një avion të mbushur me tym. Imagjinoni një motor që bën zhurmë kra-kra-kra. E frikshme.

Unë kisha një vend unik në avion atë ditë, ndodhesha në sediljen 1D. Isha i vetmi që mundesha të flisja me stjuardesën. Hodha sytë menjëherë drejt tyre, dhe ato më thanë: “S’ka problem, me siguri kemi goditur disa zogj”. Piloti e kishte kthyer tashmë avionin dhe ne nuk ndodheshim shumë larg, Manhattani shihej me sy të lirë.

Kur kaluan vetëm dy minuta, tre gjëra ndodhën në të njëjtën kohë. Piloti e drejtoi avionin përgjatë lumit Hudson (nuk është kjo zakonisht rruga që bën avioni për t’u ulur). Ai fiku motorrët. Imagjinoni tani, të

jeni në një avion ku nuk ka fare zhurmë. Dhe më pas, ai tha vetëm tre fjalë. Ishin tre fjalët më pa emocion, që kam dëgjuar ndonjëherë në jetën time: “Bëhuni gati për përplasje!”.

Nuk kisha më nevojë të flisja me stjuardesën. Mund ta shihja në sytë e saj terrorin. Jeta kish marrë fund.

Tani dua të ndaj me ju, tri gjëra që mësova në lidhje me veten time atë ditë.

Mësova se gjithçka mund të ndryshojë në një moment. Ne kemi listat tona të dëshirave, kemi listat e gjërave që duam të bëjmë në jetë, dhe unë mendova për të gjithë njerëzit që kisha dashur të takoja por nuk e kisha bërë, të gjitha urat që kisha dashur të ndërtoja me njerëzit, të gjitha eksperiencat që kisha dashur të kisha. Teksa mendoja gjithë këto, më vonë u fiksova me një shprehje, që është: “Unë koleksionoj verëra

të këqia”. Sepse nëse vera është gati dhe personi është aty, unë e hap menjëherë.

Unë nuk dua të shtyj më asgjë në jetën time. Dhe kjo ndjesi urgjence, ky sens qëllimi e ka ndryshuar vërtetë jetën time.

Gjëja e dytë që mësova atë ditë është se, unë kam jetuar një jetë të mirë, një jetë plot qëllime dhe jam përpjekur vazhdimisht të përmirësohem në gjithçka që kam bërë në jetë. Por, nga ana tjetër, kam lejuar vazhdimisht egon time që të ndërhyjë. Dhe u ndjeva i penduar për kohën që kisha harxhuar, për gjëra që nuk kanë rëndësi, me njerëz që kanë rëndësi.

Mendova për marrëdhënien me bashkëshorten time, me miqtë, me njerëzit. Dhe më pas, teksa reflektoja mbi këtë gjë, mora vendimin të eliminoja energjinë negative nga jeta ime. Nuk është perfekte, por është shumë më mirë.

Nuk kam patur një grindje me time shoqe prej tre vitesh dhe ndihem shumë mirë. Tani nuk përpiqem më që të kem të drejtë, thjesht zgjedh që të jem i lumtur.

Gjëja e tretë që mendova (dhe kjo ndodhi teksa ora në mendjen time numëronte mbrapsht sekondat, 15-14-13, dhe shihja ujin që afrohej dhe thoja me vete: “Të lutem shpërthe”, nuk dua që ky avion të bëhet një mijë copa siç kam parë në dokumentarë) ishte: “Ua, vdekja nuk është kaq e frikshme”. Është pothuaj sikur të jemi përgatitur për të, gjithë jetën tonë. Por ishte shumë e trishtë. Nuk doja të ikja. E dua jetën time. Dhe gjithë ai trishtim erdhi e u formësua në një mendim të vetëm, në një dëshirë: “Nuk dua të iki, sepse dua të shikoj fëmijët e mi të rriten.

Rreth një muaj më vonë, ndodhesha në një performancë artistike të time bije, e cila është


në klasë të parë. Dhe nisa të qaj si një fëmijë i vogël. Dhe gjithçka kishte gjithë kuptimin e botës për mua. Kuptova në atë moment, se e vetmja gjë që ka rëndësi në jetën time, është që të jem një baba i mirë. Mbi të gjitha, i vetmi objektiv që kam në jetën time, është të jem një baba i mirë.

Më ishte dhënë një dhuratë atë ditë, kur nuk vdiqa. Më ishte dhënë dhurata që të shihja në të ardhmen, dhe të rikthehesha e të jetoja ndryshe.

Dua që të ndaleni pak dhe të mendoni, sa gjëra që janë që nuk i bëni, sepse mendoni se do të jeni në këtë botë përgjithmonë? Si do t’i ndryshonit marrëdhëniet tuaja dhe energjinë negative në to? Dhe mbi të gjitha, a po jeni prindi më i mirë që mundeni të jeni?

Faleminderit.

Bota.al



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Dushku: Zhvillimi dhe fuqizimi i klubeve, prioritete të FBK-së

PRISHTINË, 10 JANAR - Sekretarëshja e Përgjithshme e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Elvira Dushku, është riemëruar edhe për një mandat shtesë (4-vjeçar) në këtë pozitë. Përkushtimi në punë dhe performanca e shkëlqyeshme në detyrat e saj bënë që bordi i FBK-së njëzëri ta miratojë propozimin e kryetarit Arben Fetahu për riemërimin e Dushkut në këtë pozitë e që, në fakt, është një post që sjell me vete shumë përgjegjësi, por është edhe nder e privilegj të jesh sekretarëshja e përgjithshme e federatës së dytë më të madhe sportive në vend. Dushku në vitin 2017 ishte emëruar ushtruese e detyrës së sekretarës së përgjithshme, ndërsa pas një viti bordi i FBK-së ia kishte besuar pozitën e sekretarëshsë së përgjithshme me mandat katërvjeçar. Atëbotë Dushku ka qenë e vetmja grua në pozitën e ekzekutives në një federatë apo organizatë sportive. Dushku përfaqëzonte të FBK-së ka folur për të arriturat me FBK-në në mandatin e saj të parë dhe për punën që e pret në mandatin e dytë së bashku me bordin, stafin e zyrës ekzekutive dhe të gjitha grupet e tjera të interesit të Federatës.

Cfarë do të kishit veçuar nga të arriturat me FBK-në në mandatin tuaj të parë?

Të arriturat me FBK-në në mandatin tim të parë do t'i kisha ndarë në katër pika: Edukimi im në pozitën e lideres ekzekutive së një organizate të madhe sportive, siç është Federata e Basketbollit të Kosovës, prej së cilës presin të gjithë shumë dhe nga ky edukim qëllimi ka qenë që, krahas meje, të përfitojnë të gjithë të tjerët, duke filluar nga vetë federata si organizatë sportive, por edhe anëtarët e tjerë që janë pjesë e zyrës, gjë që edhe ka ndodhur. Ndërtimi i zyrës, pra krijimi i stafit të zyrës ekzekutive dhe krijimi i një ambienti të mirëfilltë për punë, si dhe krijimi i një standardi të punës brenda zyrës ekzekutive, gjithnjë duke u bazuar në qeverisje të mirë, llogaridhënie dhe transparencë. Ndërtimi i raporteve të mira me të gjitha grupet tona të interesit, punë të cilën në vazhdimësi duhet ta bëjmë.

Hartimi i Planit Strategjik Pesëvjeçar të FBK-së, për herë të parë në histori të Federatës. Pra, këto kanë qenë disa nga të arriturat e FBK-së në mandatin tim të parë, të cilat do të kisha dashur t'i veçoj, por që sigurisht se për t'i realizuar të gjitha këto ne e kemi në krye një lider shembull siç është kryetari Fetahu, i cili me punën e tij të palodhshme, por edhe shumë të

mençur, mua më shtynë që të shkoj hapave të tij për realizimin e objektivave tona të përbashkëta në federatë. Krahas mbështetjes së kryetarit, bordi gjithmonë është krahas meje, sepse unë me të vërtetë e bëj punën me përkushtim dhe angazhim maksimal, ndërsa sa i përket stafit të zyrës ekzekutive mund të them se jemi rritur dhe zhvilluar së bashku, duke mësuar nga njëri-tjetri, por që sigurisht se si përgjegjëse e zyrës ekzekutive deri më tani mendoj se e kam udhëhequr me mjaft sukses punën dhe zhvillimin e anëtarëve të tjerë të stafit të zyrës.

Për çfarë jeni krenare më së shumti nga mandati juaj i parë në pozitën e sekretarëshsë së përgjithshme të FBK-së?

Ajo për çfarë krenohem më së shumti është se kur e kam marrë detyrën e u.d. sekretarëshsë së përgjithshme më 2017 kemi qenë vetëm tre persona të punësuar në zyrë, ndërsa sot ne jemi 13 anëtarë/e që jemi pjesë e zyrës ekzekutive, që do të thotë se jemi rritur dhe zhvilluar, gjithnjë sipas nevojave të parapara gjatë këtij procesi të rritjes si organizatë. Secili anëtarë i stafit të zyrës është pjesë e programeve të ndryshme të edukimit në FIBA, që na bënë të jemi shumë krenarë me investimet që i bëjmë në stafin tonë, në ndërtimin e tyre, por edhe në zhvillimin e vetë federatës. Pra, ne jemi rritur shumë si federatë, por kjo nuk do të thotë se duhet të vetëkënaqemi, sepse jemi të vetëdijshëm se na pret një punë shumë e madhe në vitet në vazhdim për ta implementuar Planin Strategjik 2021-2025.

Të ndalemi te Planin Strategjik i FBK-së. Viti 2021 ka qenë viti i parë i fillimit të implementimit të tij. Sa jeni të kënaqur me ecurinë e këtij plani?

Planin Strategjik i FBK-së 2021-2025 është përgatitur në bashkëpunim me FIBA-n dhe ne së bashku me zyrtarët e FIBA-s që janë përgjegjës për zhvillimin e federatave nacionale çdo tre muaj e bëjmë analizën e punës së arritur brenda tre muajve, gjashtë muajve dhe, së fundi, kemi arritur ta bëjmë edhe analizën e nëntëmujorit të parë. Mund të them me plot mburje se jemi shumë të kënaqur me të arriturat tona në këtë nëntëmujor, gjë që na ka dhënë motivim shtesë për të punuar edhe më shumë në vitin e dytë të implementimit të këtij plani. Është shumë më lehtë kur i ke objektivat e qarta brenda një organizate, e ke bordin dhe stafin prapa vetes dhe e tëra që duhet të bësh është ta udhëheqësh implementimin e realizimit të këtyre objektivave.



Cilat janë objektivat e FBK-së për vitin 2022?

Zhvillimi dhe fuqizimi i klubeve tona do të jetë ndër objektivat me prioritet për FBK-në në këtë vit, ku në bashkëpunim me FIBA-n do të organizojmë seminare për menaxhimin e klubeve/organizatave sportive, në të njëjtën kohë do të mundohemi sa më shumë të komunikojmë me klube, si dhe kështu ta bartim përvojën tonë te klubet. Por për ta realizuar këtë duhet një vullnet i dyanshëm, e që besoj se në këtë rast nuk mungon nga të dyja palët. Ne mendojmë se sa më të forta dhe më të zhvilluara do të jenë klubet tona, aq më i fuqishëm do të jetë sporti ynë, pra basketbolli, por edhe vetë federata. Fuqizimi i grave/vajzave në basketboll, pra ne synojmë që krahas masivizimit dhe rritjes së cilësisë në basketbollin femëror, të arrijmë të krijojmë lidere, menaxhere të suksesshme, trajnere të suksesshme, gjyqtare të suksesshme e kështu me radhë. Këtu mendoj se do të kemi mjaft punë dhe do të përballemi me sfida të mëdha, por ne jemi të gatshëm që këtë objektiv ta realizojmë konform afateve kohore të paraqitura në Planin Strategjik. Stabiliteti financiar në FBK do të vazhdojë të jetë ndër objektivat kyçe edhe më 2022. Në vitin 2021 kemi qenë shumë të kënaqur me të hyrat që i kemi realizuar dhe kjo na jep forcë për të vazhduar punën për sigurimin e sponsorëve/partnerëve të tjerë të ardhshëm të federatës. Do të vazhdojmë të punojmë dhe zhvillojmë Qendrën Nacionale të Basketbollit, do të sjellim Junior NBA në Kosovë, do të punojmë me përfaqësueset e Kosovës, si dhe do të përplojmë që të zhvillojmë sa më shumë basketbollin 3x3, e që është një tjetër objektiv sfidues për ne.

SHKURT

Kryetari Muhaxheri priti në takim KT Peja

Kryetari i komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ka pritur në takim klubin e tenisit Peja, të cilin e uroi për sukseset e arritura në Ceremoninë e Laureatëve 2021, të organizuar nga Federata e Sportit të Kosovës, me ç'rast janë shpallur KT Peja - Klubi më i mirë i vitit 2021, Aja - Tenistja e vitit 2021, Melosi - Juniori i vitit 2021, Keka - Trajneri i vitit 2021, Genisi - Gjyqtari i vitit 2021 dhe Izeti - Çmimi special për shërbim ndaj sportit. Trajneri Kreshnik Arifi e falënderoi kryetarin Muhaxheri për përkrahjen e dhënë sepse të gjitha këto suksese nuk do të ishin arritur pa përkrahjen e tij, përfshirë subvencionet, infrastrukturën. Ai, po ashtu, e njoftoi kryetarin Muhaxheri se Federata e Tenisit të Kosovës i ka dhënë mirënjohje komunës së Pejës për përkrahje dhe infrastrukturë gjatë vitit 2021. Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Pejës, Xhenet Syka, e uroi KT Peja për sukseset e arritura, po ashtu e njoftoi se këtë vit do të organizohet një event shumë i madh, i cili do të mbahet në Tiranë, sepse është përzgjedhur qyteti i të rinjve evropianë dhe ata janë duke u përgatitur, sepse secila komunë që do të marrë pjesë aty do t'i prezantojë resurset e veta. "Sa i përket rinitë, prandaj shumë do të kisha qejf, që në imazhin e Pejës të jeni edhe ju", ka thënë Syka.

Sarri kërkon menjëherë largimin e Muriqit

Vedat Muriqi prej kohësh nuk bënte pjesë në planet e Maurizio Sarrit i cili ka kërkuar largimin e sulmuesit "dardan". Merkato e Lazios është e bllokuar për shkak të disa problemeve financiare dhe nuk mund të afrojë asnjë lojtar nëse nuk shet më parë. Sipas "Corriere Dello Sport", Muriqi dhe Lazzari janë lojtarët që Sarri kërkon t'i largojë. Reprerentuesi i Kosovës nga ana tjetër dëshiron të largohet sa më shpejt nga Lazio, me disa ekipe që kanë shfaqur interesim për sulmuesin 27-vjeçar. Nëse Muriqi dhe Lazzari arrijnë të largohen, Sarri do të arrijë t'i afrojë zëvendësuesit që ka në mendje.

Gjashtë medalje për Kosovën në grupmoshat e reja në xhudo

Të dielën u mbajt turneu ndërkombëtar në Lendava të Sllovenisë për grupmoshat U12, U14, U16, U21. Pjesëmarrës atje ishin 184 garues dhe 32 klube nga 4 shtete. Nga Kosova në këtë turne morën pjesë 6 garues në grupmoshën U21. Të gjithë fituan medalje, ku 4 ishin të arta, një i argjendtë dhe një i bronzitë. Bashkë me ta kanë udhëtuar edhe trajneri Driton Kuka dhe ndihmëstrajnerët Majlinda Kelmendi e Fatos Tabaku. Dardan Cena (-73 kg - i artë), Anes Veseli (-100 kg - i artë), Fatjona Kasapi (-57kg - e artë), Dëborra Gjakova (-63 kg - e artë), Muhamedin Veseli (-66 kg - i argjendtë), Rios Kuka (+100 kg - i bronzitë).

Alioski, lojtari më i mirë i Al Ahilit

Reprerentuesi i Maqedonisë, Ezgjan Alioski, edhe statistikisht është futbollisti më i mirë i skuadrës Al Ahli nga Xheda, në fund të pjesës së parë të sezonit, ose pas 15 ndeshjeve të zhvilluara. Sipas "Sofa Score", Alioski është në vendin e parë me notën 7.20, duke lënë pas Abdulrahman Gareb me 7.13 dhe Filip Brdariqin në vendin e tretë, me notën 7.04. Alioski në "Al Ahli" erdhi nga skuadra e Leeds Unitedit, në merkaton verore dhe nën emrin e tij ka edhe 4 gola të shënuara. Alioski mori pjesë në 14 nga 15 ndeshjet në këtë sezon, ndërsa Al Ahli është duke luajtur nën pritshmërinë e programuar, pasi që është në vendin e 13-të.

Genc Hamiti është lojtar i lirë

Genc Hamiti tashmë është lojtar i lirë pas largimit nga Drenica. 28-vjeçari ka një përvojë të madhe në elitën e futbollit të Kosovës, ku ka luajtur për skuadra të ndryshme si: Prishtina, Hajvalia, Ferizaj dhe, së fundmi, Drenica. Me skuadrën drenicase mesfushori në total ka luajtur 69 ndeshje duke shënuar 11 gola dhe duke dhuruar pesë asistime. Në stinorin vjeshtor Hamiti ka luajtur në pesë ndeshje me skuadrën nga Skenderaj, duke dhuruar tre asistime. Hamiti është futbollisti i cili mund të luajë si mesfushor i djathtë, por edhe si trekuartist falë aftësive shumë të mira teknike. Tashmë kanë arritur në drejtim të futbollitit dy oferta serioze nga dy skuadra të Superligës, por futbollisti është i hapur dhe për oferta të tjera.

Djokoviqi: Jam i lumtur, ndodhem këtu për të konkurruar në "Australian Open"

MELBOURNE, 10 JANAR - Ndalimi i Novak Djokoviqit për të mos hyrë në Australi për shkak të mosmarrjes së vaksinës kundër Covidit, shkaktoi shumë bujë në mbarë botën. Tenistit serb iu ndalua hyrja në Australi dhe rrjedhimisht edhe mosmarrja

pjesë në kompeticionin e njohur "Australian Open". Së fundi, pasi tenisti e dërgoi çështjen në gjykatë, mori edhe dritën jeshile për të hyrë në territorin austriak. Djokoviqi ka reaguar në rrjetet sociale duke u shprehur shumë i lumtur që

gjykata refuzoi anulimin e vizës teksa theksoi se do të konkurrojë fort në "Australian Open". "Jam i lumtur dhe mirënjohës që gjykatësi refuzoi anulimin e vizës. Pavarësisht gjithë asaj që ka ndodhur, unë dua të qëndroj dhe të përpiqem

të konkurroj 'Australian Open'. Unë mbetem i fokusuar për këtë. Fluturova këtu për të luajtur në një nga ngjarjet më të rëndësishme që kemi përpara tifozëve të mrekullueshëm", ka shkruar Djokoviqi.



Nis faza e re e seminareve kundër dukurive negative në futboll

PRISHTINË, 10 JANAR - Federata e Futbollit e Kosovës nëpërmjet zyrtarit të saj për integritet të garave, Gazmend Bojniku, ka vazhduar ciklin e ri të seminareve që kanë për qëllim ndërgjegjësimin dhe luftimin e dukurive negative siç është trukimi (kurdisja) e ndeshjeve në futboll. Të rikujtojmë se seminarët e tilla janë pjesë e planprogramit të UEFA-së dhe secila federatë anëtare e saj është e obliguar të organizojë seminare ndërgjegjësimi së paku një herë në vit me të gjitha nivelet dhe kategoritë. Seminarët tashmë janë mbajtur në Prishtinë me grupmoshat e reja; U13, U15 dhe U17. Derisa në ditët në vazhdim do të organizohen seminarët edhe në rajonet e tjera me grup moshat sipërshtuar. Gjatë këtyre seminareve zyrtari i FFK-së për integritet të garave ka ligjëruar para pjesëmarrësve për mënyrën se si duhet të veprojnë në rast se



përballen me njerëz që synojnë trukimin e ndeshjeve, si dhe për zbulimin e disa rasteve kur kanë qenë të përfshirë lojtarët, trajnerët dhe zyrtarët e klubeve. Pjesëmarrësit e këtyre seminareve kanë ndjekur nëpërmjet videoprojektorit disa shembuj të ndryshëm që lidhen me trukimin e ndeshjeve, derisa më pas pjesëmarrësit janë ndarë në grupe

punuese, ku kanë dhënë përgjigjet në pyetësorin e krijuar nga UEFA dhe FFK-në. Po ashtu, të gjithë pjesëmarrësit janë pajisur me fletushkën e re e cila është hartuar bashkërisht me zyrtarët profesionalë të UEFA-së, që përmban informacione koncize, duke përcjellur porosi të qarta në lidhje me parandalimin dhe luftimin e trukimit të ndeshjeve.

Golden State rikthehet lider në Perëndim, humb Chicago dhe Lakersat

Los Anxhelos, 10 janar - Golden State rimerr kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit në NBA pas fitores 96-82 arritur ndaj Clevelandit. Curry me 28 pikë ishte më i miri në parket për vendasit, që korrën suksesin numër 30 në kampionat. Chicago mbron kreun e renditjes në Lindje pavarësisht



prej humbjes 113-99 në fushën e Dallasi. Donçiqi ishte fantastik në fushë, autor i një "triple double" (22 pikë, 14 rebounde, 14 asistime). Nuk ndalet ekipi i Memphisit, që korri fitoren e 9-të radhazi. Viktima e radhës ishte ekipi i Lakersave, që u mund 127-119. Për miqtë u dalluan Bane me 23 pikë e Jacksoni me 21 pikë e 12 rebounde, duke i

bërë të pavlefshme 35 pikët e LeBronit për vendasit. Rikthehet te suksesi skuadra e Brooklynit, që në sekondat e fundit mundi 121-119 San Antonion, ndeshje ku u dalluan Duranti me 28 pikë e Hardeni me 26. Fiton edhe Denveri, që mundi 99-95 Oklahomën, falë 22 pikëve të Jokiqit e 22 të Morrisit.

REZULTATET

Brooklyn - San Antonio	121-119
Clippers - Atlanta	106-93
Orlando - Washington	100-102
Toronto - New Orleans	105-101
Houston - Minnesota	123-141
Oklahoma - Denver	95-99
Dallas - Chicago	113-99
Golden State - Cleveland	96-82
Portland - Sacramento	103-88
Lakers - Memphis	119-127

Ronaldo te Barcelona?

Shifrat e Cristiano Ronaldos në këtë sezon janë të mira, 14 gola nga 29 që ka shënuar Manchester Unitedi kur ai ka qenë në fushë tregojnë sesa vendimtar është. Por ylli portugez është i shqetësuar për të ardhmen e sezonit të "djajve të

kuq". Sipas medieve angleze, portugezi është i frustruar me paraqitjet e ekipit të tij dhe i zhgënjyer me taktikat dhe stilin e trajnerit të përkohshëm Ralf Rangnick. Për këtë qëllim menaxheri Jorge Mendes ka

fluturuar drejt Anglisë për t'i adresuar shqetësimet e klientit të tij. Cristiano Ronaldo erdhi te Manchester Unitedi me ambicion për ta rikthyer te titulli. Kjo jo vetëm që nuk mund të ndodhë këtë sezon, por vihet në dyshim të fortë edhe

pjesëmarrja në Ligën e Kampionëve. Kjo do të sillte largimin e Ronaldos dhe destinacioni më i mundshëm mbetet Barcelona. Marrëdhënia e mirë e agentit të tij, Jorge Mendes, me Laporta, si dhe nevoja që klubi blaugrana

ka për të gjetur përforsime të klasës së parë në sulm me kosto jo të larta, e vendos emrin e portugezit në tavolinë. Mbetet për t'u vlerësuar, sepse nëse Ronaldo do t'i kushtojë vetëm 15 milionë euro si blerje, rroga e tij është dyfishi.

SHKURT

Piloti spanjoll: Bëra gabim që garova katër sezone te Yamaha

Piloti spanjoll Maverick Vinales konsiderohej si një nga talentet e MotoGP teksa triumfohej në pistë me motorin Suzuki. Më pas erdhi transferimi te Yamaha, por gjërat nuk shkuan ashtu si duhej dhe në mesin e sezonit të kaluar ai u largua nga motori japonez. Vinales nënshkroi me Aprilia, ku edhe debutoi vjet, ndërsa këtë vit synon të rikthehet protagonist në pistë. Gjithsesi, spanjollit që deri dy vjet më parë ishte shok skuadre me Valentino Rossin, është penduar që u largua nga Suzuki. "Nuk dua të flas shumë për të shkuarën, por është e qartë që bëra një gabim që u largova nga Suzuki. Kishim një motor të mirë, por Yamaha ishte fituese, ndaj zgjidha atë rrugë. Gjërat nuk shkuan ashtu si duhet, por tani tek Aprilia jam sërish i lumtur", ka thënë 26-vjeçari Vinales.

Mbappe mund të mos rinovojë me PSG-në

Sulmuesi Kylian Mbappe ende nuk e ka vendosur të ardhmen e tij, derisa Real Madridi po bën gjithçka që ta bindë sulmuesin francez që të transferohet në "Santiago Bernabeu". Gazeta franceze "Le Parisien" raporton se sulmuesi 22-vjeçar mund të befasojë me vendimin e tij dhe të rinovojë me PSG-në. Futbollisti i kombëtares franceze po e mendon mundësinë që të vazhdojë t'u përkushtohet gigantëve francezë. Edhe pse Mbappe ka pasur dëshirë të hershme që ta veshë fanellën e Realit, ëndrra e tij mund të shtyhet për më vonë. Mbappe ka realizuar 13 gola në 24 takime me parisienët në këtë sezon. Trajneri Carlo Ancelotti ka një projekt për rindërtimin e "galaktikave", ku francezi do të ketë rol kryesor. Mosardhja e tij do të jetë një goditje e fortë për planet afatgjata të teknikut italian.

Lukaku në 'radar' të PSG-së, shihet si zëvendësues për Mbappen

Skuadra e PSG-së ka shfaqur interesim për sulmuesin e Chelseas, Romelu Lukaku. Sulmuesi belg është përplasur me trajnerin Thomas Tuchel, pas deklaratës së fundit që tregoi dëshirën për rikthimin tek Interi. Sidoqoftë, sipas "El Nacional", "blutë" janë të hapur për shitjen e ish-yllit të Evertonit, me PSG-në që shihet si favorit pasi pritet largimi i Mbappes. Raporti shton se klubi i Ligës 1 është edhe gati të shpenzojë 90 milionë euro për të nënshkruar me Lukakun dhe shton se sulmuesi mund të jetë i hapur për kalimin në "Parkun e Princave". Lukaku ka shënuar tetë gola dhe dhuruar dy asistime në 20 ndeshje për Chelsean derisa ka kontratë deri në vitin 2026.



K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85
www.krudinibardhe.com

Në bazë të rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave të punës, KRU "Drini i Bardhë" Sh.A, me datën 11.01.2022 shpallë këtë:

KONKURS

Pozita: Menaxher i njësishë operative, me kontrate pune një (1) vjeçare me mundësi vazhdimi, pune provuese gjashtë (6) muaj, vendi Deçan (1 pozitë), dhe Zyrtar i prokurimit me kontrate pune një (1) vjeçare me mundësi vazhdimi, pune provuese gjashtë (6) muaj, vendi Pejë (1 pozitë).

Detyrat e punës për Menaxher të njësishë janë:

- Menaxhon më njësishë operative, harton propozim planin vjetor të punës dhe kujdeset për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e aseteve, përcjell realizimin e planit vjetor, është përgjegjës për disiplinën në punë dhe azhurnimin brenda njësishë.

Kushtet për themelimin e marrëdhënies së punës:

- Diploma universitare drejtimi ekonomik, bujqësisë ose juridik,
- Përvoja e punës prej 3 viteve në vende të ngjashme të punës.

Detyrat e punës për zyrtar të prokurimit janë:

Përgatitë formularin në bazë të kërkesave nga njësitet e kërkesave për planifikim preliminar dhe përfundimtare të prokurimit, Në bazë të kërkesave të aprovuara nga KE inicion procedurat e prokurimit, varësisht nga vlera e tenderit bën përgatitjen e dokumenteve të ofertimit (ftesës për oferta, kërkesa për kuotime dhe kërkesa për propozime) dhe lëshimit të tyre, administrimin e tenderëve, monitorimin e procesit të prokurimit, përgatitjen e hapjes publike të ofertave dhe përpilimin e raporteve, si dhe punë tjera sipas ligjit të prokurimit.

Kushtet për lidhjen e marrëdhënies së punës:

Diplomë Universitare; fakulteti juridik, ekonomik ose fushë relevante
I Certifikuar për punë të prokurimit. Përvojë pune në prokurim 3 (tri) vite.

Procedura e aplikimit:

Dokumentet dorëzohen në zyrën nr. 1 të KRU "Drini i Bardhë" rruga "Mbretëresha Teutë" Nr. 85 Pejë.

Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit, dëshminë e përvojës së punës,
- Diplomën shkollore për kualifikimin e kërkuar - kopje,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj.

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit dhe përfundon në ora 16:00, të ditës gjegjëse.



K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85
www.krudinibardhe.com

U skladu sa Uredbom o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji poslova i radnih zadataka, RKV "Drini i Bardhe" d d, dana 11.01.2022. godine, objavljuje:

KONKURS

Funkcija: Menadžer operativne jedinice, sa ugovorom o radu od jedne (1) godine sa mogućnošću produženja, probni rad šest (6) meseci, mesto Dečane (1 pozicija), i službenik za nabavke sa ugovorom o radu od jedne (1) godine sa mogućnošću produženja, probni rad šest (6) meseci, mesto Peć (1 pozicija).

Zadaci rukovodioca jedinice su:

- Rukovodi operativnom jedinicom, izrađuje godišnji plan rada i stara se o korišćenju i održavanju imovine, prati realizaciju godišnjeg plana, odgovoran je za radnu disciplinu i ažuriranje u okviru jedinice.

Uslovi za zasnivanje radnog odnosa:

- fakultetsku diplomu ekonomije, poljoprivrede ili prava,
- Radno iskustvo od 3 godine na sličnim poslovima.

Dužnosti službenika za nabavke su:

Priprema obrazac na osnovu zahteva jedinica zahteva za preliminarno i konačno planiranje nabavki, Na osnovu odobrenih zahteva EK pokreće postupke nabavke, u zavisnosti od vrednosti tendera priprema tendersku dokumentaciju (poziv za podnošenje ponuda, zahtev za ponudu i zahtev za predloge) i njihovo izdavanje, administriranje tendera, praćenje nabavke, priprema javnog otvaranja ponuda i sastavljanje izveštaja, kao i drugi poslovi u skladu sa zakonom o nabavkama.

Uslovi za zasnivanje radnog odnosa:

Fakultetska diploma; prava, ekonomije ili relevantne oblasti
Sertifikovan za poslove nabavke. Radno iskustvo na poslovima nabavke 3 (tri) godine.

Aplikacija postupak:

Dokument se dostavlja u kancelariju br. 1 RKV "Drini i Bardhe" ulica "Mbretëresha Teute" br. 85 Peć.

Uz prijavu moraju biti priložena sledeća dokumenta:

- CV (biografija),
- Kopija lične karte, dokaz o radnom iskustvu,
- En školska diploma za traženu stručnu spremu – kopija,
- Dokaz da niste pod istragom, ne stariji od šest (6) meseci.

Rok za podnošenje prijave je 15 dana od dana objavljivanja konkursa i završava se odgovarajućeg dana u 16:00 časova.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Döner Mara" SH.P.K. me pronar Flamur Byqmeti Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811864546 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Döner Mara" D.O.O. Flamur Byqmeti Gnjilane, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811864546, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Döner Mara" L.L.C. Flamur Byqmeti Gjilan has come to the decision to quit its business: 811864546 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Ardijan Gashi shpall te pavlefshme deftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu " 17 Shkurti " Hatmaxhe.

▶ Shirina Qupi shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dugagjini " Prizren.

▶ Burim Shala shpall te pavlefshme diplomen shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Berat Kurtaj shpall te pavlefshme deftesat e kl VI - IX shfmu " Deshmoret e Zhurit " Zhure.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

